

# DeckCleaner



MAINTENANCE CLEANER



## Nga natyra – për natyrën! Pastrim i fortë me bazë bimore për ambientin tuaj të jashtëm

Pastrues normal për ambient të jashtëm. LOBA DeckCleaner pastron shpejt dhe mirë me baza bimore. Ai heq edhe papastërtitë më të forta pa shkaktuar dëme dhe është të biodegradueshëm.

- Mund të përdoret për pastrimin e përditshëm dhe pastrimin intensiv
- Shumë ekonomik
- E përshtatshme për dru të vajosur ose të llakuar si dhe WPC

### Gama e përdorimit:

E përshtatshme për pastrimin e WPC, drurit të lyer me vaj dhe të llakuar.

## Të dhëna teknike të produkteve

NR. ARTIKULLI			
10731	2,5l	6	144

<b>Vlera pH</b>	9,6
<b>Përbërësit</b>	5 - 15% sapun
<b>Magazinimi dhe transportimi</b>	36 muaj kohëzgjatja maksimale e magazinimit. Material i parrezikshëm sipas ADR. Depozitim dhe transportim në temperatura +5°C deri +25°C. Mbrojeni nga ngrica.
<b>GISCODE</b>	GU70

## Udhëzime përpunimi

- Largojeni papastërtitë e lira dhe pluhurin më parë me fshesë me korrent, fshesë ose pastrues dyshemeje.
- Kini parasysh rregullat e përgjithshme dhe specifike të sigurisë së punës për produktin. Me shumë informacion specifik në lidhje me GISCODE mund të gjendet tek udhëzimet e përdorimit, të disponueshme në [www.wingis-online.de](http://www.wingis-online.de).
- Tundni mirë materialin.

### HOLLUES

Ujë.

### MJET APLIKIMI / NORMË APLIKIMI

Pastrues dyshemeje LOBA ose Scrubber / shtoni rreth 50 - 250 ml në 10l ujë.

### PËRDORIMI:

Për pastrimin e rregullt dhe para aplikimit të LOBA DeckRefresh dhe WPC Refresh. Në varësi të gradës së ndotjes, përzieni rreth 50 - 250 ml DeckCleaner me 10l ujë. Aplikojeni tretësirën pastruese mbi sipërfaqe dhe largojeni atë pas një kohe të shkurtër veprimi me pastruesin e dyshemesë LOBATOOL. Në rastin e verandave të valëzuara ose në rastin e ndotjeve të mëdha, përpunojeni sipërfaqen me një furçë të ashpër pastrimi. Nëse është e nevojshme përsëriteni procesin e pastrimit. Në fund shpëlajini mbetjet e pastrimit me ujë të pastër. Kur aplikohet një përqendrim i lartë mund të shkaktohet edhe një shpëlarje e sipërfaqeve të vajosura. Për ta rivendosur përsëri imprenjimin, pas tharjes gjatë natës mund të aplikohet LOBA WPC Refresh (me efekt të lehtë imprenjues) ose LOBA DeckOil (me efekt të fortë imprenjues).

## Udhëzime të përgjithshme

**Pastrimi i mjeteve të punës:** Pastroni mjetet e punës me ujë menjëherë pas përdorimit.

Informacioni në këtë material si dhe të gjitha këshillat dhe rekomandimet, të cilat ofrojmë në ndihmë dhe asistencë të përdoruesit, janë rezultat i përvojës së deritanishme dhe u referohen kushteve Speziale. Për shkak të mundësive të shumta të aplikimit dhe kushteve të përpunimit, nuk përjashtojmë nevojën e përdoruesit për të kryer testimet e veta ose të kërkojë këshilla teknike duke kontaktuar me Departamentin e aplikimit teknik LOBA. Respektoni standartet aktuale dhe rekomandimet e prodhuesit të produkteve për shtrimin-përpunimin e parketeve. Detyrimet dhe përgjegjësia jonë përcaktohet ekskluzivisht nga Termat dhe Kushtet tona dhe nuk zgjerohen as përmes këtij informacioni as përmes këshillave tona. Publikimi i të dhënave më të reja teknike automatikisht zhvlerëson ato të mëparshme.

**Koha e tharjes:** Kohët e dhëna të tharjes vlejné në +20°C dhe në 50% lagështirë ajri relative. Temperaturat më të ulëta, lagështia relative më e lartë e ajrit shkakton vonesa të tharjes. Para arritjes së fortësisë finale mos pastroni me leckë të lagur. Karakteristikat specifike të produktit gjenden në informacionet teknike përkatëse.

Fjalët dhe simbolet me shenjën ® përfaqësojnë të drejta tregu, të cilat janë të regjistruara dhe të mbrojtura të paktën për hapësirën e Gjermanisë.